UDHËZIM
Nr.36, datë 9.11.2009

PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR.30, DATË 26.9.2007 "PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE DHE DOKUMENTACIONIT QË DUHET TË PARAQESË SUBJEKTI JURIDIK, PËR HAPJEN E NJË INSTITUCIONI PRIVAT TË ARSIMIT TË LARTË OSE PROGRAMEVE TË STUDIMIT NË CIKLIN E PARË DHE CIKLIN E DYTË TË STUDIMEVE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 44 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë",

UDHËZOJ:

1. Pikat 4.1 dhe 4.2 të kreut III "Detyrimet që rrjedhin nga licencimi i institucionit privat të arsimit të lartë" të udhëzimit nr.30, datë 26.9.2007 të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, të ndryshuar, revokohen.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm dhe Drejtoria e Politikave të Arsimit të Lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj